

**Drejtuar:**

Këshillit Mësimor - Shkencor të Fakultetit Juridik  
Universiteti i Tetovës, Rr. e Ilindenit, p.n. 1200, Tetovë

Në bazë të vendimit me nr. 14-62/2 të datës 23.03.2022 të Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Juridik të Universitetit të Tetovës për formimin e Komisionit për vlerësimin e disertacionit të doktoraturës me titull: **“Regjimi juridik i imunitetit diplomatik në Republikën e Maqedonisë së Veriut”**, të kandidatit Mr. Sc. Nail Isufi, Komisioni në përbërje: Prof. Dr. Bashkim Selmani, kryetar; Prof. Dr. Ali Musliu, anëtar; Prof. Dr. Arta Bilalli, anëtar; Prof. Dr. Agim Nuhiu, anëtar; Prof. Dr. Altin Shegani, mentor, Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Juridik i paraqet këtë:

**RAPORT**

**për vlerësimin e disertacionit të doktoraturës**

▪ **Të dhënat biografike të kandidatit**

Nail Isufi u lind më 12 janar 1987 në fshatin Dëbërcë, Komuna e Zhelinës. Shkollën fillore e kreu te “Pashko Vasa”, Grupçin, Komuna e Zhelinës, ndërsa Shkollën e Mesme te SHAM “Kiril Pejçinoviç”, Tetovë.

Në vitin 2009 ka kryer studimet e Baccalaureus i drejtësisë në Fakultetin Juridik, në Universitetin e Tetovës. Gjithashtu, ka përfundur edhe studimet e magjistraturës në Fakultetin Juridik në Universitetin e Tetovës në vitin 2014. Nga viti 2017 ka regjistruar studimet e doktoraturës në Fakultetin Juridik në Universitetin e Tetovës, në drejtimin: Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Historia e Diplomacisë.

▪ **Pjesëmarrja në konferenca ndërkombëtare shkencore**

Duke filluar nga viti 2016, kandidati Nail Isufi ka marrë pjesë në disa konferenca shkencore ndërkombëtare, edhe atë:

- Në Konferencën Ndërkombëtare Shkencore “The Law and Challenges of the Euro-Atlantic Processes”, mbajtur në datën 18-19.11.2016 në Universitetin e Tetovës, Tetovë.

- Në Konferencën Ndërkombëtare Shkencore “Security Challenges and Universal Standards in the Euro-Atlantic Integration Process”, mbajtur në datën 17-18.11.2017 në Universitetin e Tetovës, Tetovë.
- Në Konferencën Ndërkombëtare Shkencore “The Rule of Law and Civil Society”, mbajtur në datën 19-20.10.2018 në Universitetin e Tetovës, Tetovë.
- Në Konferencën Ndërkombëtare Shkencore “European Perspective of the Western Balkans”, mbajtur në datën 13-15.11.2019 në Universitetin e Tetovës, Tetovë.
- Në Konferencën Ndërkombëtare Shkencore “Towards a Better Future: Human Rights, Organized Crime and Digital Society”, mbajtur në datën 30.10.2020 në Universitetin “Sv. Kliment Ohridski”, Manastir.

▪ **Anëtarësimi në revistat ndërkombëtare shkencore**

Nga viti 2020 është anëtarë i Revistës Ndërkombëtare Shkencore International Journal of Law and Society, ISSN Print: 2640-1894, ISSN Online: 2640-1908, Nju Jork, SHBA. Ndërsa, nga viti 2021 është anëtarë i Revistës Ndërkombëtare Shkencore International Law Research, ISSN(Print): 1927-5234; ISSN(Online): 1927-5242, Kanadë.

▪ **Punimet shkencore të publikuara në revista shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare**

Deri tani kandidati Nail Isufi ka botuar këto punime shkencore në revista të ndryshme shkencore ndërkombëtare:

- Isufi, N. (2017). “Metodika e zbulimit të vrasjeve në Republikën e Maqedonisë dhe në Komunën e Tetovës”, International Journal of Legal Sciences, Justicia, UDC: 34, ISSN: 1857-8454 (Print), Vol. 5, No. 8, pp. 116-125.
- Isufi, N. (2018). “The Development of the European Union”, International Journal of Legal Sciences, Justicia, UDC: 34, ISSN: 1857-8454 (Print), ISSN: 2545-4927 (Online), Vol. 6, No. 10, pp. 76-80.

- Isufi, N. (2019). "North Atlantic Treaty Organization", *International Journal of Legal Sciences, Justicia*, UDC: 34, ISSN: 1857-8454 (Print), ISSN: 2545-4927 (Online), Vol. 7, No. 12, pp. 124-130.
- Isufi, N. (2020) "Diplomatic Relations Between European Union and China", *International Journal of Legal Sciences, Justicia*, UDC: 34, ISSN: 1857-8454 (Print), ISSN: 2545-4927 (Online), Vol. 8, No. 13-14, pp. 154-160.
- Isufi, N. (2020). "Diplomatic Rank According to Vienna Convention on Diplomatic Relations and the Law on Foreign Affairs of the Republic of North Macedonia", *International Journal of Legal Sciences, Justicia*, UDC: 34, ISSN: 1857-8454 (Print), ISSN: 2545-4927 (Online), Vol. 8, No. 13-14, pp. 161-167.
- Isufi, N. (2020). "The Legal Nature of Consuls Immunity", *International Journal Acta Universitatis Danubius. Juridica*, Print ISSN: 1844-8062, Online ISSN: 2065-3891, Vol. 16, No. 1, 2020, pp. 89-101.
- Isufi, N. (2020). "The Legal Nature of Diplomatic and Consular Functions", *Balkan Journal of Interdisciplinary Research, International Institute for Private, Commercial, and Competition Law*, ISSN 2410-759X (print), ISSN 2411-9725 (online), Vol. 6, No. 1, 2020, pp. 87-96.
- Isufi, N. (2020). "The Subjects of International Law and its Role in the Protection of Human Rights", *Conference Proceedings, Volume II*, ISBN 978-608-4670-15-5 (V. 2), pp. 177-187.
- Isufi, N. (2021). "The Protection of Human Rights and Freedoms According to International Laws and Domestic Laws in North Macedonia-Comparative Aspects", *POLIS International Scientific Journal*, ISSN 2223-8174, No 20/2021, pp. 56-73.

▪ **ANALIZË E DISERTACIONIT TË DOKTORATURËS**

▪ **Informacione lidhur me lëndën e hulumtimit**

Në këtë hulumtim shkencor kandidati Nail Isufi pas konsultimeve paraprake me Prof. Dr. Altin Shegani, mentor, si titull i disertacionit të doktoraturës ka zgjedhur: "Regjimi juridik i imunitetit diplomatik në Republikën e Maqedonisë së Veriut". Punimi në fjalë është i një

rëndësia të veçantë në ditët e sotme, që nënkupton se rëndësia e tij vlen jo vetëm për të ardhmen e vendeve të rajonit por edhe për shtetin tonë, siç është Republika e Maqedonisë së Veriut.

Përmes këtij punimi janë analizuar të gjitha elementet të cilat lidhen drejtpërdrejtë ose tërthorazi me tematikën në fjalë, duke i dhënë kësaj të fundit një koncept sa më përmbajtësor dhe shkencor, dhe që ka të bëjë kryesisht me regjimin juridik të imunitetit diplomatik.

### **Informacione lidhur me gjendjen në fushën shkencore në të cilën është punuar disertacioni**

Në lidhje me imunitetin diplomatik kanë shkruar autorë të ndryshëm, por në këtë punim janë shfrytëzuar libra të ndryshme të autorëve vendas dhe atyre ndërkombëtarë të cilat konsiderohen si më të rëndësishme dhe që njëherit janë në dobi dhe në funksion të tematikës së përzgjedhur.

Punimi mbështetet në disa të dhëna burimore. Kësisoj, në punim janë shfrytëzuar disa të dhëna të ndryshme nga Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, të cilat kanë lidhje të ngushtë me imunitetin diplomatik.

Përveç të dhënave të përmendura më lartë, krahas literaturës kryesore qoftë nga autorë vendas ose ndërkombëtar, punimi gjithashtu mbështet edhe në disa konventa ndërkombëtare të cilat e rregullojnë në esencë regjimin juridik të imunitetit diplomatik.

Disertacioni i doktoraturës me titull: “Regjimi juridik i imunitetit diplomatik në Republikën e Maqedonisë së Veriut”, i kandidatit Nail Isufi është realizuar nga fusha shkencore juridike-ndërkombëtare, e cila përveç rëndësisë juridike dhe ndërkombëtare e njëjta ka edhe rëndësi politike-institucionale. Gjithashtu, ky punim para së gjithash fokusohet në disa konventat ndërkombëtare të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë e rregullojnë çështjen e imunitetit diplomatik dhe të cilat kanë efekt të drejtpërdrejtë në legjislacionin e brendshëm të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Më tutje, punimi analizon rastet të cilat kanë të bëjnë me kryerjen e funksionit diplomatik nga ana e përfaqësuesve diplomatik brenda dhe jashtë Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe që lidhen kryesisht me imunitetin diplomatik i cili garantohet me konventa ndërkombëtare dhe ligjet e brendshme. Kësisoj, analizimi dhe vlerësimi i akteve të

lartpërmendura është bërë me anë të metodave të ndryshme shkencore të cilat përveç qasjes teorike, gjejnë zbatim edhe në jetën praktike dhe njëherit janë në dobi dhe në funksion të vetë titullit.

Prandaj, përmes këtij punimi shkencor synohet që lexuesit të njihen me institucionin e imunitetit diplomatik, respektivisht me natyrën juridike të imunitetit diplomatik, me qëllim të ketë koncept mbi këtë nocion me përmbajtje të zgjeruar, si dhe të njihet edhe me praktikën e shteteve të tjera në rajon dhe më gjerë lidhur me imunitetin diplomatik dhe në veçanti të njihet me natyrën juridike të imunitetit diplomatik në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Disertacioni i doktoraturës me titull: “Regjimi juridik i imunitetit diplomatik në Republikën e Maqedonisë së Veriut”, i kandidatit Nail Isufi është sistemuar në një tërësi duke radhitur çdo temë brenda kapitullit përkatës, me qëllim që të krijojë një trajtim më përmbajtësor i cili në mënyrë të vazhdueshme i shtron specifikat e tematikës. Kështu, punimi përbëhet nga tre pjesë e cila në vete përmban disa kapituj dhe nënkapituj, përfshirë pjesën hyrëse dhe përfundimin.

Në pjesën e parë të punimit, trajtohet historia e institucionit të imunitetit diplomatik. Në të shpjegohet kuptimi dhe rëndësia juridike e imunitetit diplomatik. Rëndësi i është kushtuar edhe aspektit të krahasimit të institucionit të imunitetit të diplomatëve që nga kohërat më të hershme e deri në ditët e sotme, në fakt cili ka qenë roli i tyre, që nga emërimi dhe çfarë ndikimi kanë ata sot në përfaqësimin e shtetit të tyre në marrëdhëniet diplomatike. Një pjesë e nënkapitullit, flet për teorinë mbi imunitetin diplomatik duke mos lënë anash doktrinën e “eksterritorialitetit”, e cila është mjaft e rëndësishme në të drejtën ndërkombëtare. Teori tjetër përmendet “karakteri përfaqësues”, që njëherit është edhe si parim bazë e përfaqësuesve diplomatik. Si një ndër funksionet e tyre kryesore dhe i fundit përmendet “teoria funksionale”, e cila u mundëson diplomatëve privilegje të caktuara. Gjithashtu, janë trajtuar disa konventa ndërkombëtare të cilat në tërësi e rregullojnë çështjen e imunitetit diplomatik duke filluar nga imuniteti personal, penal, civil, etj.

Rëndësi të veçantë në këtë pjesë i është kushtuar edhe të drejtës së legacionit, e cila është një normë mjaft e rëndësishme në të drejtën ndërkombëtare. Sidoqoftë, e drejta e legacionit, përfshinë të drejtën për të akredituar përfaqësuesin diplomatik në shtetet e tjera si dhe të drejtën për të pranuar përfaqësues diplomatik kur ato akreditohen nga shtetet e tjera.

Ajo që e bënë të rëndësishme këtë pjesë është edhe roli i Ministrisë së Punëve të Jashtme, si një urë lidhëse e shtetit në raport me shtetet e tjera që lidhet me punën dhe kryerjen e detyrimeve të përfaqësuesve diplomatik.

Në ushtrimin e funksioneve diplomatike dhe konsullore, përveç imunitetit të diplomatëve dhe të konsujve janë trajtuar shkurtimisht edhe subjektet e tjera të cilat gëzojnë imunitet nga legjislacioni i brendshëm dhe ndërkombëtar. Madje, krahas titujve diplomatik të cilët i gëzojnë përfaqësuesit diplomatik është analizuar gjerësisht roli i tyre në ushtrimin e të drejtave të tyre të cilat prekin imunitetet dhe privilegjet si imunitete personale të tyre. Përveç imunitetit personal si e drejtë e pacenuar subjektive, shpjegime janë dhënë edhe për sendet tjera të cilat po ashtu gëzojnë paprekshmëri të cilat janë të radhitura në mënyrë taksative. Të drejtën e gëzimit të disa imuniteteve dhe privilegjeve e gëzojnë edhe konsujt. Këtë materie e rregullojnë konventat ndërkombëtare, të cilat parashohin disa rregulla të ndryshme në ushtrimin e postit konsullor apo të shërbimit konsullor. Pikërisht, në këtë pjesë të punimit i është kushtuar rëndësi edhe shërbimit konsullor, që ka të bëjë kryesisht me imunitetet dhe privilegjet e tyre.

Pjesa e dytë e punimit më tepër fokusohet në llojet e imunitetit diplomatik, që konsiston në kategorizimin e tyre, duke filluar nga imuniteti personal, penal, civil, etj. Kështu, përveç imunitetit personal, privilegje dhe imunitete gëzojnë edhe vetë godinat konsullore të cilat nuk guxojnë të preken nga organet e rendit të shtetit pritës. Ajo që e bën më specifike këtë paprekshmëri të godinave diplomatike dhe konsullore janë edhe rastet kur një gjë e tillë nuk është marrë aspak parasysh nga organet e rendit të shtetit pritës të cilët thuajse kanë hyrë me dhunë në ndërtesat e përfaqësive diplomatike dhe konsullore. Pikërisht këto veprime konsiderohen të paligjshme, duke marrë parasysh aspektin e tyre penal dhe ndërkombëtar dhe njëherit janë në kundërshtim me ligjet dhe konventat ndërkombëtare. Prandaj, si rezultat i shkeljes së konventave të tilla, janë paraqitur edhe disa raste të brendshme që lidhen me keqpërdorimin e imunitetit diplomatik, si dhe disa raste të njohura në praktikën ndërkombëtare që lidhen po ashtu me keqpërdorimin e imunitetit diplomatik. Këto raste, janë trajtuar më gjerësisht në pjesën e tretë të punimit.

Në pjesën e tretë dhe të fundit të punimit janë trajtuar rastet e fillimit dhe përfundimit të imuniteteve diplomatike-konsullore, keqpërdorimi i imuniteteve dhe privilegjeve diplomatike dhe në kapitullin e fundit të kësaj pjese i është kushtuar rëndësi edhe mbrojtjes ndërkombëtare të

imunitetit diplomatik. Në këtë drejtim, esenciale është akti i njohjes së shteteve si parakusht për themelimin e përfaqësive diplomatike, ku më pas vjen në shprehje edhe imuniteti diplomatik i cili ushtrohet nga ana e përfaqësuesve diplomatik brenda territorit të shtetit pritës, duke mos anashkaluar rregullat e brendshme të tij dhe të akteve ndërkombëtare. Rëndësi i është kushtuar edhe kushteve të emërimit të përfaqësuesve diplomatik, të cilët krahas kushteve të përgjishme të njohura në praktikën ndërkombëtare, ata duhet të plotësojnë edhe disa kushte të veçanta të cilat janë të specifikuara në ligjet e brendshme të shteteve të ndryshme. Kushtet e tilla i gjejmë edhe në Ligjin për shërbimin e jashtëm të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në pjesën e cila i referohet përfundimit të imuniteteve dhe privilegjeve diplomatike, janë trajtuar dhe analizuar disa raste të cilat përfshijnë një periudhë të caktuar kohore dhe për të cilat janë dhënë konkluzione. Nga ana tjetër, vlen të theksohet se imuniteti diplomatik gëzon edhe mbrojtje ndërkombëtare e cila sigurohet përmes konventave ndërkombëtare.

Sa u përket rasteve të keqpërdorimit të imunitetit diplomatik, të cilat janë kryer nga përfaqësuesit e huaj diplomatik në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe anasjelltas, ato raste u përkasin një periudhe të caktuar kohore, duke filluar nga viti 2005, respektivisht nga viti 2007 deri në vitin 2021.

Në lidhje me keqpërdorimin e imunitetit diplomatik nga ana e përfaqësuesve diplomatik të Republikës së Maqedonisë së Veriut jashtë vendit, këto kryesisht kanë të bëjnë me veprën penale si vjedhja, rastet e aksidenteve në komunikacionin rrugor që kanë për pasojë vdekjen, keqpërdorimi i detyrës zyrtare, etj.

Dhe, kapitulli i fundit i pjesës së tretë të punimit trajton mbrojtjen ndërkombëtare të imunitetit diplomatik e cila sigurohet përmes konventave ndërkombëtare si dhe imunitetet dhe privilegjet në organizatat ndërkombëtare.

Në fund të punimit kandidati ka dhënë përfundimet dhe rekomandimet e mëtejshme.

#### ▪ **Përshkrimi i shkurtër i metodave të përdorura**

Në disertacionin e doktoraturës me titull: “Regjimi juridik i imunitetit diplomatik në Republikën e Maqedonisë së Veriut”, kandidati Nail Isufi,

ka respektuar të gjitha standardet metodologjike të krijimit të punimit shkencor. Në këtë drejtim, metodat të cilat janë përdorur në këtë punimit janë: metoda historike, metoda krahasuese, metoda hulumtuese, metoda e analizës, metoda statistikore dhe metoda e intervistës.

#### ▪ **Përshkrimi i shkurtër i rezultateve të hulumtimit**

Mendojmë se ky punim është i qëlluar dhe përmbajtësor i cili jo vetëm që do t'i kontribuojë shkencës në përgjithësi, por efektet e tij do të materializohen edhe në jetën praktike. Prandaj, krahas shfrytëzimit të literaturës ndërkombëtare me përmbajtje të tematikës, është shfrytëzuar edhe literaturë nga autorë vendas të cilët kanë trajtuar dhe trajtojnë në kontinuitet problematikën e imunitetit diplomatik, duke mos anashkaluar ligjet dhe aktet ndërkombëtare për këtë qëllim. Pikërisht, për këtë qëllim dhe përmes krahasimeve të bazuara në literaturën ndërkombëtare dhe vendase, përfshirë ligjet dhe konventat ndërkombëtare si dhe të dhënat e siguruar nga Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, është zbardhur edhe identifikimi i problemit të hulumtimit shkencor.

Imuniteti diplomatik si institucion i lashtë edhe sot e kësaj dite zë vend qendror në marrëdhëniet diplomatike midis shteteve. Nga ana tjetër, roli i Ministrisë së Punëve të Jashtme në përgjithësi, dhe në veçanti i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, çdoherë duhet të shërbejë si një urë lidhëse në raport me shtetet e tjera, kur bëhet fjalë për imunitetin e diplomatëve.

Nëse shikojmë raportin e numrit të përfaqësive diplomatike-konsullore, sipas të dhënave zyrtare të siguruar nga Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, rezultoi që më tepër ka përfaqësi diplomatike në Republikën e Maqedonisë së Veriut sesa ka Republika e Maqedonisë së Veriut jashtë vendit, që njëherit paraqet mungesë të aftësisë së shtetit për të hyrë në marrëdhënie diplomatike me shtetet e tjera, që është si element kryesor i shteteve, krahas elementeve të tjera. Mirëpo, situata ndryshon te Konsujt e Nderit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, që numri i tyre është dyfish më i madh në raport me konsujt e nderit të shteteve tjera.

Në emërimin e ambasadorëve, vlen të theksojmë se secili shtet krahas kushteve të veçanta, të cilat janë të parapara në ligjet përkatëse, duhet të plotësohen edhe kushtet e përgjithshme të cilat janë të njohura dhe të pranuar ndërkombëtarisht. Kjo nënkupton që edhe në Republikën e



Maqedonisë së Veriut një gjë e tillë duhet të merret parasysh sidomos në zgjedhjen e personave për ambasador të ardhshëm të cilët doemos duhet të plotësojnë kushtet e përgjithshme të cilat janë të pranuar ndërkombëtarisht.

Pjesa e cila ka të bëjë me funksionet diplomatike dhe konsullore dhe që lidhet me imunitetin e tyre, ajo që i bën të përbashkët është karakteri përfaqësues që është një funksion jashtëzakonisht i rëndësishëm në marrëdhëniet ndërkombëtare, edhe përkundër dallimeve që ekzistojnë midis tyre.

#### ▪ **Kontributet kryesore shkencore të kandidatit**

Gjatë periudhës së përgatitjes së disertacionit të doktoraturës, kandidati Nail Isufi, në mënyrë aktive është përfshirë në hulumtimin dhe analizën e problemeve që janë të lidhura në mënyrë direkte ose indirekte me temën e përzgjedhur. Ai gjithashtu, është përfshirë edhe në përgatitjen e punimeve shkencore të lartpërmendura të cilat për pasojë kanë pasur publikimin e tyre në revista të njohura ndërkombëtare dhe të cilat njëherit kanë lidhje të përafërt me titullin e disertacionit të doktoraturës.

Kandidati në vazhdimësi ka marrë pjesë në disa konferenca të ndryshme ndërkombëtare shkencore, në të cilat ka pasur rastin që të prezantojë punime të ndryshme shkencore nga lëmia e të drejtës ndërkombëtare publike, të marrëdhënieve ndërkombëtare, si dhe të drejtës diplomatike dhe konsullore.

#### ▪ **Fushën shkencore në të cilën do të aplikohen**

Institucioni i imunitetit diplomatik është trajtuar që nga kohërat më të hershme dhe në shkencën juridike njihet si institucion i lashtë i cili vazhdon të zë vend qendror edhe në ditët e sotme, pavarësisht periudhave kohore nëpër të cilat ka kaluar. Nga këtu vlen të theksohet se imuniteti diplomatik gëzon vend të veçantë jo vetëm në shkencat juridike por edhe në shkencat e tjera të cilat përafërsisht e rregullojnë këtë materie. Njëkohësisht, konsiderojmë se është temë e qëlluar pasi konsiston të sqarojë kuptimin dhe rëndësinë juridike dhe ndërkombëtare si dhe politike-institucionale të imunitetit diplomatik, pasi ka lidhje të drejtpërdrejtë me përfaqësuesit diplomatik dhe për këtë arsye ata gëzojnë imunitete dhe privilegje të caktuara në shtetin pritës. Pikërisht, ky punim është realizuar nga fusha shkencore

juridike-ndërkombëtare, por gjithnjë duke përfshirë rëndësinë politike-institucionale. Në këtë drejtim, vlen të përmendim se përfaqësuesit diplomatik janë të emëruar nga shteti dërgues në shtetin pritës, të ngarkuar me të drejta dhe detyrime me qëllim që ta përfaqësojnë shtetin në marrëdhëniet diplomatike me shtetet e tjera, dhe si të tillë kanë gëzuar dhe gëzojnë privilegje dhe mbrojtje të veçantë.

Punimi i kandidatit Nail Isufi është zgjedhur me qëllim që të trajtojë aspektin juridik dhe ndërkombëtar të imunitetit diplomatik si nocion i përgjithshëm dhe në veçanti regjimin juridik të imunitetit diplomatik në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Ashtu siç përmendëm pak më lartë, punimi në fjalë fokusohet në disa konventat ndërkombëtare të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë e rregullojnë çështjen e imunitetit diplomatik dhe të cilat kanë efekt të drejtpërdrejtë në legjislacionin e brendshëm të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Përmes këtij punimi janë analizuar dhe trajtuar disa raste të cilat kanë të bëjnë me të drejtat dhe detyrimet e përfaqësuesve diplomatik që lidhen kryesisht me imunitetin e tyre, të cilat garantohen me ligje dhe konventa ndërkombëtare.

Gjithashtu, në punim janë marrë në konsideratë edhe disa ligje të shteteve në rajon, në veçanti Ligji për shërbimin e jashtëm të Republikës së Maqedonisë së Veriut, natyrisht gjithnjë duke marrë parasysh konventat ndërkombëtare të cilat drejtpërdrejtë e rregullojnë çështjen e imunitetit diplomatik. Kësisoj, analizimi dhe vlerësimi i akteve të lartpërmendura është bërë përmes metodave të ndryshme shkencore me qëllim që punimi të jetë në dobi dhe në funksion të vetë titullit.

#### ▪ **Hulumtime të mundshme të ardhshme**

Disertacioni i doktoraturës me titull: “Regjimi juridik i imunitetit diplomatik në Republikën e Maqedonisë së Veriut”, i kandidatit Nail Isufi paraqet një punim me përmbajtje dhe rëndësi politike-institucionale, që nënkupton se kandidati, por edhe studiuesit e tjerë si dhe bartësit e funksioneve publike, e sidomos diplomatët mund të trajtojnë disa çështje më specifike që ka vetë përmbajtja e punimit. Prandaj, mund të thuhet se kandidatit përveç njohurive të fituara më parë dhe brenda kësaj periudhe, do t’i shërbejnë si mundësi që të trajtojë tema të ndryshme ose të ngjashme edhe në të ardhmen të cilat lidhen kryesisht me fushën e tij shkencore.

## PËRFUNDIMI DHE PROPOZIMI

Disertacioni i doktoraturës me titull: “Regjimi juridik i imunitetit diplomatik në Republikën e Maqedonisë së Veriut”, i kandidatit Nail Isufi është i një rëndësie të veçantë në ditët e sotme, rëndësia e së cilës vlen jo vetëm për të ardhmen e vendeve të rajonit por edhe për shtetin tonë, siç është Republika e Maqedonisë së Veriut. Njëherit, ky punim cilësohet si punim i pavarur shkencor, që sipas metodologjisë së kryer është adekuat për të vlerësuar aftësitë e kandidatit si hulumtues i pavarur shkencor.

Komisioni për vlerësimin e disertacionit të doktoraturës me titull: “Regjimi juridik i imunitetit diplomatik në Republikën e Maqedonisë së Veriut”, i kandidatit Nail Isufi, konstaton se punimi në fjalë i plotëson të gjitha kriteret shkencore të përcaktuara dhe i propozon Këshillit Mësimor–Shkencor të Fakultetit Juridik të Universitetit të Tetovës që të miratojë këtë raport dhe të lejojë mbrojtjen publike.

### **Komisioni:**

1. Prof. Dr. Bashkim Selmani, kryetar
2. Prof. Dr. Ali Musliu, anëtar
3. Prof. Dr. Arta Bilalli, anëtar
4. Prof. Dr. Agim Nuhiu, anëtar
5. Prof. Dr. Altin Shegani, mentor

